



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË KORÇE**

VENDIM

Nr 84 date 26.11.07

PER

ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE "T.SH.SH.F.P" Sh.a

Bazuar ne nenin 128 dhe 132 paragrafi i pare i ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregetare" Keshilli Bashkiak me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregetare "T.SH.SH.F.P" sh.a me kapital 100 % shteteror , mori në shqyrtim Rendin e ditës me kete permbajtje

1. Diskutim dhe miratim i Relacionit te Shoqërisë " T.SH.SH.F.P. për realizimin e operaconit të Zmadhimit të Kapitalit të nënshkrar të shoqërisë , me vlerësim të kontributit në natyrë të investuar në shoqëri nga fillimi i aktivitetit deri në 31.12.2006.
2. Diskutim dhe miratim i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar si dhe Ekspertëve vlerësues , të emëruar në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve .
3. Diskutim dhe miratim i zamdhimit te kapitalit të nënshkruar si dhe i caktimit të vlerës së një aksioni.
4. Diskutim dhe miratim te ndryshimeve Statutore për kapitalin e nenshkuar te shoqërisë

Mbasi shqyrtoi pikat e mesiperme Keshilli Bashkiak me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise Tregetare "T.SH.SH.F.P" sh.a

VENDOSI

1- Te miratoje Relacionin e Drejtorisë së Shoqërisë " T.SH.SH.F.P. për realizimin e operaconit të Zmadhimit të Kapitalit të nënshkrar të shoqërisë , me vlerësim të kontributit në natyrë të investuar në shoqëri nga fillimi i aktivitetit deri në 31.12.2006, per shumen 280.931.148 leke, sipas burimeve te financimit te percaktuara ne relacionin perkates.

2- Te miratoje Raportin të Eksperti Kontabël të Autorizuar, i permbledhur si dhe raportin e Ekspertëve vlerësues , të emëruar në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve, sipas te cilit mbi vleren e kontributit te vleresuar ne natyre te investuar sipas burimeve te shprehura ne raport per shumen 280.931.148 leke, kapitali i nenshkuar te zmadhohet per shumen 276.000.000 leke. Se bashku me shumen prej 2.000.000 leke te kapitalit themeltar, kapitali i nenshkuar arrin ne shumen 278.000.000 leke.

Ne kontabilitetin e Shoqerise te sistemohet vlere e kapitalit te nenshkuar, te paderdhur prej 2.000.000 leke e depozituar ne momentin e rregjistrimit te shoqerise, vlere kjo e cila perfshihe brenda vleres se kontributit te investuar. Shifrat e tjera, difference ne vleren e kontributit natyre, te sistemohen ne rezervat ligjore. Fitimet e mbartura te pasqyruara ne bilanc te perfshihen si investim ne kontributin ne natyre, ne kapitalin themeltar

3- Te miratoje zmadhimin e kapitalit të nënshkruar per shumen 275.000.000 leke si dhe cakton vleren e nje aksioni ne masen 10.000 leke. Mbi vleren e kapitalit te nenshkuar ne shumen 275.000.000 caktohen 27.500 aksione te cilat jane ne pronesi te aksionerit te vetem, Bashkise Korce.

4- Konform legjislacionit ne fuqi te behet rregjistrimi i zmadhimit te kapitalit prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit

5- Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise Tregetare "T.SH.SH.F.P" sh.a te realizoje ndryshimet statutore per efekt te zmadhimit te kapitalit, vleres dhe numrit te aksioneve, si dhe depozitimin e ndryshimeve ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

6- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARE E KESHILLIT

Rajmonda NASE

Rajmonda Naze